

Reportazhi i BBC Janar 2024: Pyetjet që bëhen Shpesh [FAQ]

Ju mund të jeni në dijeni të raportit të BBC mbi shërbimet e maternitetit në këtë Trust. Kjo faqe ju jep një panoramë, si dhe përgjigje për pyetjet që mund të keni.

Paralajmërim për përmbajtjen: kjo faqe ka përmbajtje të ndjeshme në lidhje me humbjen e fëmijëve dhe vdekjen e grave shtatzëna.

Shërbimi ynë ndihet shumë keq kur nënës ose foshnjës i ndodh ndonjë dëm sepse ne synojmë të ofrojmë kujdesin më të mirë të mundshëm për çdo familje, çdo ditë. Ne jemi të vendosur të mësojmë dhe të ndryshojmë kur gjërat shkojnë keq. Si pasojë e hetimeve tona të brendshme dhe të pavarura, ne kemi bërë ndryshime të rëndësishme tek shërbimet tona të maternitetit.

Kur ndodhin incidente të tilla, ne jemi të hapur në lidhje me to dhe i raportojmë në mënyrën e duhur. Dëshirojmë të theksojmë se raste të tilla janë shumë të rralla po të krahasohen me 6000 lindje që kryhen gjatë çdo viti tek shërbimet tona të maternitetit. Këtu nuk kërkohet të zbehet në asnjë mënyrë ndikimi i këtyre incidenteve që janë raportuar në program, ku të gjithë janë hetuar në mënyrë të plotë.

Ne dëshirojmë të ndajmë disa informacione për t'ju treguar se si jemi duke i përmirësuar shërbimet tona dhe se si mësojmë prej incidenteve. Ne kemi një ekip të ri drejtues të maternitetit dhe kemi rritur numrin e mamive dhe mjekëve në shërbim për të mbështetur gratë dhe foshnjat, si dhe një sërë përmirësimesh të tjera në fushën e sigurisë.

Ndryshimet e rëndësishme që janë bërë drejtohen nga personeli ynë, i cili punon ngushtë me familjet dhe komunitetet për t'u siguruar që të gjithë të thonë fjalën e tyre në mënyrë që ne të ofrojmë kujdesin më të mirë dhe më të sigurt.

Pyetjet që bëhen shpesh (FAQ)

Ne kemi përgatitur disa përgjigje për "Pyetjet që Bëhen Shpesh" (FAQ), të cilat mund t'ju ndihmojnë të mësoni më shumë.

P) A janë të sigurta Shërbimet e Maternitetit në Spitalet e Gloucestershire?

Ne jemi të bindur se shërbimet tona të maternitetit janë të sigurta.

Gjatë viteve të fundit kemi bërë ndryshime të rëndësishme në lidhje me shërbimet tona të maternitetit. Ato drejtohen nga personeli ynë, i cili punon ngushtë me familjet dhe komunitetet për t'u siguruar që të gjithë të thonë fjalën e tyre në mënyrë që ne të ofrojmë kujdesin më të mirë dhe më të sigurt.

P) A është i sigurt induksioni i lindjes?

Induksion mund t'ju ofrohet nëse nuk filloni lindjen natyrshme deri në javën e 41-të. Çdo shtatzëni është e ndryshme dhe ekipi i mamive dhe maternitetit do t'ju dëgjojë dhe do ju japë këshilla dhe mbështetje për të siguruar një lindje të sigurt.

P) A ka vonesa gjatë induksionit?

Siguria e të gjitha grave merret parasysh dhe i jepet përparësi ofrimit të kujdesit 1:1 për gratë në shtatzëni të avancuar. Ekipi i Maternitetit organizon 'takime induksioni' dy herë në ditë (ky është një takim i ekipit shumë-disiplinor për të shqyrtuar rrugëtimin e secilës grua) për të garantuar sigurinë e tyre dhe për të ngritur çdo shqetësim.

P) BBC raportoi se vdekshmëria lidhur me shtatzëninë në Gloucestershire është më e lartë se mesatarja kombëtare - çfarë do të thotë kjo?

Humbja e nënës apo foshnjës është një tragjedi dhe është shkatërruese për familjen e tyre. Të gjitha vdekjet lidhur me shtatzëninë raportohen dhe monitorohen nga Njësia Kombëtare e Epidemiologjisë Perinatale (NPEU) në Universitetin e Oksfordit dhe përmbledhen në [Raportin MBRRACE](#).

Për shumicën e rasteve të vdekjeve kryhen hetime të pavarura për të kuptuar se çfarë ndodhi dhe për të nxjerrë mësim të cilat mund të ndahen me familjet dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor.

Pavarësisht se BBC ka deklaruar se shkalla e vdekshmërisë lidhur me shtatzëninë në Gloucestershire është dyfishi i mesatares kombëtare, Trusti dhe ekupe të pavarura nga Universiteti i Oksfordit dhe Sistemi Vendor i Maternitetit dhe Porsalindurve, kanë shqyrtuar të dhënat dhe konfirmojnë se norma në nivelin vendor nuk ndryshon statistikisht dukshëm nga norma e Mbretërisë së Bashkuar.

P) Pse Panorama është fokusuar tek Gloucestershire?

Programi eksploron sfidat kombëtare dhe vendore lidhur me rekrutimin dhe plotësimin me personel dhe gjithashtu përfshin tre vdekje shumë tragjike të grave shtatzëna dhe neonatale në spitalet tona.

Ai gjithashtu fokusohet në ndikimin ndaj përjetimit të personelit, i cili ndihet i paaftë për të shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me sigurinë ose mendojnë se nuk i kushtohet vëmendje.

Rastet tragjike të paraqitura në dokumentar ndodhën ndërmjet viteve 2019 dhe 2021 dhe secili u hetua në mënyrë të pavarur nga një organ i jashtëm i quajtur Dega e Hetimit të Sigurisë Shëndetësore - një organ i krijuar posaçërisht për të ofruar hetime të pavarura për rastet e vdekjeve në maternitet.

P) Si është përmirësuar shërbimi i Maternitetit?

Shërbimet e Maternitetit janë vazhdimisht në një proces transformimi dhe si Trust ne jemi të përkushtuar të mësojmë dhe të ndryshojmë kur gjërat shkojnë keq dhe tashmë kemi bërë përmirësime të rëndësishme në shërbimet tona të maternitetit ku përfshihen:

- Ekipi i ri dhe i zgjeruar i menaxhimit
- Kemi shtuar numrin e mamive dhe mjekëve në shërbim për të mbështetur gratë dhe foshnjat
- Kemi punuar me personelin për t'u fokusuar në sigurinë e pacientit, për të mësuar dhe për përmirësimin e vazhdueshëm.
- Është prezantuar një rol i ri i mamisë-konsulente, i cili forcon mbikëqyrjen e mamisë ndaj kujdesit të udhëhequr nga Mamia
- Program i vazhdueshëm i rekrutimit dhe mbajtjes së çersomelit për të reduktuar vendet e punës të paplotësuara dhe për qarkullimin e personelit.
- Përmirësimi i "Vlerësimit të rrezikut të vendit të lindjes" për të shmangur vonesat në aksesin në kujdesin urgjent nëse është e nevojshme.
- Tre takime informimi të përditshme mbi sigurinë, ku vlerësohen personeli, ngarkesa e punës dhe lindjet e induktuara, duke u siguruar që çështjet të adresohen menjëherë.
- Forcimi i shërbimit tonë të brendshëm "Liria e shprehjes"
- Ofrimi i një shumëllojshmërie të mbështetjeje për personelin, duke përfshirë shërbimet e mirëqenies dhe psikologjike, rrjetet e kolegëve dhe kampionët e sigurisë.

Që nga Prilli 2020, ne kemi investuar 1.8 milion £ shtesë për të rritur personelin e Mamive dhe numri i mamive që punojnë në repart është rritur nga 242.99 (2020) në 263.77 (Dhjetor 2023.)

P) Si është përmirësuar performanca e Trustit?

Edhe pse programi fokusohet tek shërbimet e maternitetit, mënyra se si ne i përgjigjemi çështjeve të sigurisë në spitalet tona është një çështje e rëndësishme për të gjitha shërbimet

tona. Në qendër të kësaj është puna jonë për të përmirësuar dhe zhvilluar një kulturë të hapjes dhe dëgjimit - një kulturë që mbështet punonjësit të flasin dhe të dëgohen për çështje që lidhen me kujdesin dhe sigurinë e pacientit.

Informacion mbështetës dhe pyetje shtesë

Kontaktoni ekipin tonë

Në rast se pyetja juaj nuk gjen përgjigje këtu, ju keni mundësi të ndryshme për të kontaktuar ekipin tonë në varësi të urgjencës së pyetjes:

- Flisni me maminë që ju është caktuar
- Kontaktoni Ekipin tonë të Përvojës së Pacientit duke telefonuar në numrin 0800 019 3282 ose dërgoni email në adresën: ghn-tr.helpelinesupport@nhs.net
- Na dërgoni një mesazh drejtpërdrejtë në [Facebook](#); [Instagram](#) ose [X \(ish Twitter\)](#)

Mbështetje tjetër në nivel vendor

- Kontaktoni [Gloucestershire Maternity Voices Partnership](#)
- Kontaktoni [Forget-Me-Not support group](#)

Organizata kombëtare mbështetëse

Nëse jeni të prekur nga çështjet e ngritura në program dhe ato nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin tonë për gratë shtatzëna, mund të përfitoni nga një sërë opsionesh që ofrojnë mbështetje tek:

- [Sands](#) (humbja e foshnjës dhe mbështetja e familjes)
- [Tommys](#) (humbja e foshnjës dhe mbështetje)
- [Cruse](#) (mbështetje për humbjen e një të afërmi)